

## Zyrtar për borxhe komunale për pasuritë komerciale

Në bazë të dispozitave të nenit Nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore sh.a Prishtinë shpallë:

### K O N K U R S

#### **Për zgjedhjen e Zyrtarit për borxhe komunale për pasuritë komerciale të Ndërmarrjes Publike Banesore - SHA me seli në Prishtinë.**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e e Zyrtarit për borxhe komunale për pasuritë komerciale:
  - Përcjellë rregullisht gjendjen e borxheve të qiramarrësve ndaj kompanive publike.
  - Kontakton me kompani publike lidhur me borxhet e qiramarrësve.
  - Përgatit dokumentacionin e nevojshëm dhe lajmëron qiramarrësit e rinj në kompanitë publike përkatëse.
  - Bën ndërrimin e qiramarrësve në kompanitë publike, varësisht prej shfrytëzuesit të pasurisë komerciale.
  - Njofton qiramarrësit për borxhet si dhe kërkon që t'i paguajnë ato.
  - Angazhohet në punët tjera në Divizionin e Qirasë.
  - Raporton për punët e kryera çdo fund të javës.
  - Kryen edhe punë tjera me kërkesë të Udhëheqësit të Divizionit të Qirasë.
  - Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të Divizionit të Qirasë.

1. Kualifikimi dhe kushtet tjera të veçanta:

- Fakulteti Ekonomik apo Administrim Biznesi.
- Së paku dy vite përvojë pune në fushën e ngjashme.
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara.
- Në gjendje për të punuar nën presion.
- Shkathtësi të mira komunikimi.
- Njohja e gjuhës angleze
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

1. Procedura e Konkurimit

Kandidati për e Zyrtarit për borxhe komunale për pasuritë komerciale duhet t'i dorëzoj këto dëshmi:

- CV;
- Letër Motivimi;
- Dëshminë e Kualifikimit Profesional;
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit; dhe
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune.

**Konkursi është i hapur nga data 31.05.2016 – 14.06.2016**

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, Bulevardi "Bill Clinton", p.nr., Prishtinë ose përmes e-mailës zyrtare: burimet [njerezore@npbanesore.com](mailto:njerezore@npbanesore.com). Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet shënuar saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.